



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:271773  
Datë: 12.04.2024  
Numri i dokumentit: 05566531

**C-IV-14-0912**

*Parashtruesi i kërkesës*

**S B**, fshati K, Komuna e Klinës

*kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH NNIT “Mirusha” në likuidim)**, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 12 prill 2024 lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ068-0034 datë 6 shkurt 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 18 shkurt 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e Vendimit (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) PEJ068-0034 datë 6 shkurt 2014, lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (në tekstin e mëtutjeshëm AL) me anë të cilit, kërkesa për kompensim për kontribute pensionale, në shumë prej 430.00 (katër tre zero) Euro, ndaj NSH NNIT “Mirusha”, është refuzuar.

Ankuesi Vendimin e AL e konteston për shkak shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesi konsideron se Vendimi i AL është kontradiktor për vet faktin se nuk e përcakton qartë në dispozitiv pranimin e kërkesës së tij por ka lënë të nënkuptohet si mënyra të ndryshme të vendosjes.

Ankuesi konsideron se AL ka shkelur parimin e dëgjimit të palës tjetër pasi që konsideroj se është dashur ta ftoj dhe dëgjoj në procedim të rregullt ashtu që ti jepej mundësia e deklarimit dhe sqarimit.

Ankuesi konsideron se baza e kërkesës kreditore të tij qëndron në dispozitat ligjore të Ligjit për AKP dhe Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës nenit 6 paragrafi 2a dhe 2b.

Ankuesi tutje konsideron se një kërkesë e ngjashme është iniciuar edhe pranë Gjykatës Komunale në Klinë, nga ana e punëtorëve të NSH e kundër NSH.

Ankuesi përfundimisht konsideron se AL gabimisht ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për fondet pensionale duke u thirrur në dispozitat ligjore të Ligjit për AKP si ligji të vetëm.

Nga gjitha arsyet si më lartë, ankuesi propozon që kërkesa e tij kreditore të aprovohet përfshirë edhe kamatën ligjore.

Kërkesës për rishikim-ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e padisë, në gjuhë Angleze, së punëtorëve e parashtruar pranë Gjykatës Komunale në Klinë (tani degë e gjykatës themelore),
- Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, datë 7 shkurt 2006, dhe
- Kopja e një liste të punëtorëve.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 12 gusht 2021 parashtrorj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP mbështeti Vendimin e AL si të bazuar në dispozitat ligjore dhe në pajtim të Ligjit për AKP (shtojca e ligjit). AKP gjithashtu theksoj se ankesa nuk përmban argumentet ligjore, të përcaktuar sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP pohoj se shumica nga pagat, për fondin pensional, si nga punëdhënësi e po ashtu edhe nga punëtori, duhet të barten në Fondin e kursimeve pensionale- Trustit e jo edhe ankuesit, ashtu siç parashihet sipas Ligjit për fondet pensionale. Nga gjitha AKP propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës ankuesi me 15 tetor 2021 parashtrorj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi kundërshtoj pretendimet e dhëna nga ana AKP. Ankuesi edhe njëherë kundërshtoj Vendimin e AL dhe mbeti pranë asaj që kërkesa e tij për rishikim-ankesa të aprovohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopje e kalkulimit të pagave për muajin gusht 2003,
- Kopja e listës së pagave të punëtorëve të NSH për muajin gusht 2003,
- Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, datë 7 shkurt 2006, dhe
- Kopja e siç shihet, e një pjese të Aktvendimit të DHPGJS – AC-I-14-0323.

AKP me 18 janar 2022 parashtrorj kundërpërgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes së saj.

### **Arsyetimi ligjor**

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrirat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Ankuesi fillimisht sipas kërkesë së tij kreditore, nuk ka specifikuar se sa ishin të ardhurat e tij pranë NSH, periudhën për të cilën pretendohet, të gjitha këto me qëllim të përcaktimit të obligimit të pagesës së kontributeve pensionale.

Për më tepër gjykata konsideron se AL me rastin e vendosjes drejtë ka vlerësuar dispozitat ligjore me rastin e refuzimit të kërkesës, për arsytet si në vijim.

Kjo kategori e kërkesave nuk bie në kategorinë e kërkesave kreditore, ashtu siç janë përcaktuar sipas dispozitave ligjore të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, të cilat do të takonin dhe paguheshin punëtorëve, por këto kërkesa duhet dhe që AL është i obliguar që të paguaj pranë Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës, ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Fondit pensional të Kosovës (neni 6.2 paragrafi a dhe b).

Po sipas Ligjit për fondet pensionale, nenin 6.10 thuhet, citat: *“Punëdhënësit duhet të paraqesin listën e të gjithë punonjësve në Administratën Tatimore të Kosovës në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Punëdhënësi duhet të listoj e gjithë punonjësit e tij me numrat e tyre personal identifikues, dhe shumën e kontributeve të punëdhënësit dhe punëmarrësit për t’u paguar. Raportim i tillë do të bëhet para se të bëhet pagesa e kontributeve”*.

Dispozita e lartëcekur nënkupton se është se është obligim i punëdhënësit, në këtë rast AKP si administruese që të veproj në përputhje me ligjin dhe obligimet mbi pagesën e shumës së kontributeve të raportoj pranë Administratës Tatimore të Kosovës.

### **Subjekti tatimor versus Administrata tatimore**

Për më tepër, pavarësisht Vendimit të AL dhe pohimeve të AKP në përgjigje, sipas Ligjit për tatimin në të ardhurat personale, ligj në fuqi në kohën e marrjes së Vendimit, ( LIGJI nr. 3/L-0161 ) si dhe Ligjit për Fondet pensionale në Kosovë ( LIGJI Nr. 04/L-101) – ligj ky në fuqi në momentin e vendosjes nga AL, subjekt i obligimit mbi përmbushjen e obligimeve të fondeve të kursimeve pensionale duhet të jetë NSH NNIT “Mirusha”. Kjo për faktin sepse ankuesi pretendon të drejtën në pagesën kontributeve pensionale, si punëtor -i punësuar pranë NSH.

Administrata Tatimore e Kosovës – ATK, në rastin kur një subjekt tatimor, si në rastin konkret NSH NHNI “Morava e Binçës”, konstaton se nuk janë kryer obligimet, si ato të Kontributet Pensionale, sipas autorizimeve të saj të dhëna sipas Ligjit mbi procedurën tatimore dhe procedurat, ligj në fuqi në kohën e marrjes së Vendimit nga AL, ( Ligji nr. 03/L-222) ushtron kompetencat e saj ligjore ndaj subjektit tatimor, në këtë rast NSH, dhe kërkon përmbushjen e obligimeve të pa-paguara ligjore, të cekura si më lartë.

Në rastin konkret, ATK në rastin kur konstaton mos përmbushjen e obligimeve si më lartë, duhet ti drejtohet AL me kërkesë mbi përmbushjen e gjitha obligimeve tatimore të papaguara të një subjekti, përfshirë edhe pagesën e kontributeve pensionale, të gjithë punëtorëve të punësuar (neni 6 i Ligjit për fondet pensionale në Kosovë).

Andaj gjykata me rastin e shqyrtimit të Vendimit të AL, vendosi sipas nenit 74 të Ligjit për DHPGJS.

### **Taksat gjyqësore**

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksat gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është nën shumën 1,000.00 Euro.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar